

Rrethanat e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit

- ▶ Ndryshimi tek furnizuesi i mundësisë së fundit për shkak të:
 - falimentimit apo paafesise pague,se,
 - pezullimit apo heqjes së licenses të furnizuesit aktual,
 - apo kur klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg

Veprimet procedurale mbas konstatimit të rrethanave të mosfurnizimit

- ▶ Furnizuesi aktual është i detyruar të informojë:
 - Klientët,
 - Operoret e sistemit
 - furnizuesin e mundësisë së fundit në ditën që pasojat ligjore të falimentit dhe likuidimit, kanë ndodhur
- ▶ Operatori i sistemit duhet të percjelle të dhenat e matjes për pikën/pikat e shpërndarjes
 - klientit,
 - furnizuesit aktual,
 - furnizuesit të mundësisë së fundit,
- ▶ Në rast se licenca e furnizuesit aktual përfundon, është pezulluar apo hequr, pa asnjë vonesë, ERE do të informojë:
 - të gjithë operatorët e sistemit,
 - furnizuesin e mundësisë së fundit mbi heqjen apo pezullimin e licenses së furnizimit.
- ▶ Operatori i sistemit duhet të paraqesë të dhenat matjes të pikës/pikave të shpërndarjes/furnizimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dorëzimi i njoftimit të ERE

Klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të ligjit për sektorin e energjisë elektrike, del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit. Në përfundim të kësaj periudhe, operatori i sistemit ndërpret furnizimin me energji elektrike të këtij klienti. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit, sipas kësaj dispozite, llogaritja e afateve fillon nga e nesërmeja e ditës kur operatori i rrjetit njofton klientin, në përputhje me parashikimet e nenit 109, të ligjit të sipercituar, për plotësimin e kushteve teknike të instalimit të sistemit të matjes për daljen në treg të liberalizuar.